

AS 42 PLK # N
nr. Dred. 223
dt 21/03/2017



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI KOMBËTAR I UJIT
Këshilli i Basenit Ujëmbledhës Seman

VENDIM

Nr18 Datë 16/02/2017

Për

miratimin në parim të kërkesës, për përdorim të burimit ujore te perroit Voskopojes dege e lumit Devollt, për prodhim hidroenergjie në Bashkin Korce Qarku Korce.

Në mbështetje te ligjit 111/2012 “Per menaxhimin e integruar te burimeve ujore” neni 5, neni 12 pika 1, neni 13 pika 2 d, neni 50 pika 2. Vendimit Nr 416 date 13.05.2015 Keshillit te Ministrave “Per miratimin e kushteve te pergjitheshme e te posacme,dekumentave shoqeruse,afatit te vlefshmerise,formularve te aplikimit per autorizim dhe leje,procedurave te shqyrtimit e vendimarrjes dhe formateve te autorizimit e lejes per perdorim te burimeve ujore”. Vendimit te Keshillit Kombetare te Ujit Nr 5 date 16.02.2016 “Per miratimin e rregullores “Per organizimin dhe funksionimin e Keshillit te Basenit Ujore si dhe Vendimi te Keshillit Kombetare te Ujit Nr 6 date 16.02.2016 “Per miratimin e rregullores “Per funksionimin e Agjencise se Basenit Ujore” Keshilli i Basenit Ujëmbledhës Seman.

VENDOSI:

Miratimin në parim të kërkesës, për përdorim të burimit ujore te perroit Voskopojes dege e lumit Devoll, për prodhim hidroenergjie në Bashkin Korce Qarku Korce.

Me keto kordinatat:

X=4501535 Y=465195 Z 1156 m mnd

X=4502328 Y=465554 Z= 1162 mmnd

X=4503183 Y=463396 Z= 1063 mmnd.

Prurja mesatare Qmes = 0.802 m3/sek

Prurja qe jepet ne perdorim Q = 1.6 m3/sek

Prurja ekologjike Qekol = 0.126 m3/sek

Ky burimi ujon do te perdoret per prodhim energjie pasi te plotesohen me pare kushtet e meposhme:

- Te mos cenoj furnizimin me uje te popullates dhe te industrise per nevojat e tanishme dhe te prespektives.
- Te zbatoj grafikun per vaditje ne kohe (dite) dhe ne sasi (l/s) per cdo vite te hartuara nga Bordet e Kullimit te pushtetit vendore dhe ate Qendrore.
- Te respektoj grafikun e vaditjes edhe jashte periudhes kur e kerkon Bordi i Kullimit .
- Te respektoj rrjedhjen ekologjike.
- Si dhe duke plotesuar kushtet e percaktuara nga institucionet qendrore dhe lokale.

Ngarkohet AUB Seman për zbatimin e këtij vendimi.

PËRGJEGJËSI AUB SEMAN

Isuf Myrtaj



KRYETARI I KBU

SEMAN

Xhevit Bushaj

